

VENDIM
Nr.1062, datë 21.10.2009

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË KATËR AUTOKOLONAVE USHTARAKE
SLLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 20 tetor 2009, të 2 (dy) autokolonave ushtarake sllovene, të përbëra, si më poshtë vijon:
 - Autokolona e parë nga 2 (dy) automjete dhe 5 (pesë) trupa.
 - Autokolona e dytë nga 3 (tri) automjete dhe 7 (shtatë) trupa.
 2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 28 tetor 2009, të 2 (dy) autokolonave ushtarake sllovene, të përbëra, si më poshtë vijon:
 - Autokolona e parë nga 4 (katër) automjete dhe 15 (pesëmbëdhjetë) trupa.
 - Autokolona e dytë nga 2 (dy) automjete dhe 6 (gjashtë) trupa.
 3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat e para, të përmendura në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, që do të hyjnë, përkatësisht, në datat 20 e 28 tetor 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes porti i Durrësit.
 4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat e dyta, të përmendura në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, që do të hyjnë, përkatësisht, në datat 20 e 28 tetor 2009, është porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.
 5. Autokolonat ushtarake sllovene, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
 6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha